



**USAID | MACEDONIA**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



6 dhjetor, 2012 ora 11:00  
Zyra për informim: +389 (0) 310-2314  
Celulari: +389 (0)70 367 547  
Email: [bvelickovska@usaid.gov](mailto:bvelickovska@usaid.gov)  
Kontaktto projektin:  
Celular #: +389 70 290 122  
E-mail: [xhpruthizajazi@mcgo.org.mk](mailto:xhpruthizajazi@mcgo.org.mk)

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### **Mbështetja e SHBA-ve për renovimin e shkollës fillore Tefejuz në Shkup**

Sot, më 6 Dhjetor, 2012, Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik në Arsimit bashku me shkollën fillore "Tefejuz" dhe Komunën e Çairit organizuan ceremoninë e kremtimit solemn, me të cilin shënohet përfundimi i suksesshëm i renovimit të shkollës. Procesi i renovimit është mbështetur financiarisht nga Komanda e Shteteve të Bashkuara për Evropë (EUCOM) dhe USAID-i, me çka do të krijohet një mjedis më i mirë për integrim ndëretnik në arsim.

"Integrimi ndëretnik nuk është asnjëherë proces i lehtë në asnjë pjesë të botës" tha Drejtori i Misionit të USAID-it Robert Wuertz. "Integrimi ndëretnik kërkon dëshirë, persistencë dhe përpjekje nga ana e arsimtarëve, prindërve, menaxhmentit të shkollës dhe liderëve të komuniteteve. Për atë shkak, ne të rriturit kemi përgjegjësi të edukojmë të rinjtë; sjellja jonë është gjithmonë shembull tek ata; për atë ne duhet të jemi shembull pozitiv tek gjeneratat e reja."

Projekti i USAID-it për integrim ndëretnik mbështet dhjetë bashkësi dhe shkolla tjera në drejtim të riparimit të godinave shkollore, duke përfshirë edhe shtigje për të krijuar qasje më të mirë për fëmijët me nevoja të posaçme. Projekti zgjat katër vite dhe ka buxhet prej 5.2 milion dollarëve i kofinansuar nga USAID-i dhe Komanda e SHBA-ve në Evropë, që do të bashkëpunojnë me të gjitha palët përkatëse arsimore për ta mbështetur Qeverinë e Republikës së Maqedonisë në orvatjet e saj për integrim etnik. Projekti do ta ngrit vetëdijen dhe do të ofrojë trajnim të ndryshëm, mbështetje teknike dhe iniciativa para bordeve të shkollave, drejtorëve, arsimtarëve dhe punëtorëve administrativ të shkollave. Për më shumë informacione vizitoni: [www.pmio.mk](http://www.pmio.mk)

### SHËNIM PËR REDAKTORËT:

Populli amerikan përmes USAID-it nga viti 1993 në Maqedoni ka investuar më shumë se 500 milion dollarë. Projektet për implementim të USAID-it kanë qenë të fokusuar në krijimin e vendeve të punës, reduktimin e korrupsionit dhe përgatitjen e nxënësve të Maqedonisë për nevojat e tregut të punës. Këta iniciativa e përmirësojnë cilësinë e jetës dhe e mbështesin Maqedoninë nga rruget e tranzicionit drejt një demokracie të qëndrueshme dhe të prosperueshme. USAID-i ofron ndihmë ekonomike dhe humanitare në më shumë se 100 shtete. Për më shumë informacione vizitoni <http://macedonia.usaid.gov> ose faqen tonë në Facebook: <http://www.facebook.com/USAIDMacedonia>